



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN **Nr. 58, Datë 11.06.2018**

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti Kontraktor	Inspektoriati Qendror
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të monitoruara	1
Lloji i procedurës/ave të monitoruara	Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
Konstatimet kryesore	1. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 46, pika 1, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me hartimin e disa prej kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe në kundërshtim me nenin 61, pika 2, të VKM 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me argumentimin e këtyre kriterëve. 2. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 36, pika 4, të VKM 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me argumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar në procedurë. 3. AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 53, pika 3, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit.
Masat e marra	1. Në bazë të nenit 72, pika 1/gj, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP

	vendosi të dënojë me gjobë tre anëtarët e njësisë së prokurimit. 2. Në bazë të nenit 72, pika 1/i, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë tre anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.
--	---